REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI BASHKIAK LUSHNJE

KOMISIONI EKONOMISE,PROBLEMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT

Nr 10432 Prot.

Lushnje,më 20.11.2025

VENDIM

NR.20 DATE 20/11/ 2025

PER SHQYRTIMIN E PROJEKT VENDIMIT NR 99 DATE 12.11.2025: PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDET E BUXHETIT VENDOR PER MUAJIN TETOR 2025 .

-Komisioni Ekonomise,problemeve Sociale dhe Strehimit i mbledhur me date 20/11/2025 shqyrtoi projekt vendimin nr 99 date 12.11.2025 relacionin ,dokumentat shoqeruese te paraqitur nga kryetari i bashkise,dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit dhe materialeve shoqeruese

V E N D O S I:

1-Ti propozoj keshillit bashkiak Lushnje miratimin e projekt aktit nr 99 date 12.11.2025 : Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin **Tetor** 2025 .

Kryetari i Komisionit Aida Kapia

N/Kryetar Alvin Gjoka

Sekretar _____

Anetar Ercan Bano

Anetar Vasilika Haxho

Anetar _____

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
KËSHILLI BASHKIAK
Komisoni i Përhershëm i Ekonomise, Problemeve Sociale dhe Strehimit
(Adresa, lagja Kongresi i Lushnjesnr. Tel. 0696420431)

RAPORT VENDIMMARRJE
Nr.03 datë 20.11.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.99 datë 12.11.2025, relacionit dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimit, në lidhje me propozimin **"Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor për muajin Tetor 2025"**

Analiza ligjore: Projekt vendimi eshte konform bazueshmerise ligjore te percaktuar ne relacionin bashkangjitur nga kryetari i bashkise.

Raporti i vendimarrjes se komisionit mbeshtetet ne nenin 35/1 "Funksionet dhe detyrat e komisioneve te perhershme" te rregullores te keshillit bashkiak, te miratuar me vendim nr.37/2024.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

- Nevoja per kete vendim percaktohet nga kerkesat e familjeve qe nuk jane perfituese te skemes se ndihmes ekonomike, pra kane dale nga sistemi i pikezimit, nga aplikimi ne sistem 3 muajt e fundit

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

- Pagesa eshte brenda planit te fondeve te kushtezuara te parashikuara ne buxhetin e miratuar nga keshilli i bashkise per vitin 2025 dhe nga fondi 6% te fondit te kushtezuar (te rekomanduar nga sistemi). Do te trajtohen me fondin 6% 35 familje/72 anetare dhe me buxhetin e bashkise 105 familje/201 antare.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin

-Drejtoria e Sherbimeve sociale-pergjegjese

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

-Drejtoria e Sherbimeve Sociale-monitoron dhe raporton

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Perfitojne grupet ne nevoje sipas vleresimit me pike dhe verifikimit ne terren nga drejtoria pergjegjese.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015)

Nuk eshte objekt i konsultimit publik, bazohet ne listat e dala dhe te miratuara nga sistemi i pikezimit dhe verifikimit.

Komisioni i Përhershëm për "Ekonomine, problemet sociale dhe strehimin", i mbledhur me datën 20.11.2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.99 datë 12.11.2025, relacionit dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për **"Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin Tetor 2025".**
Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur vendimit te komisionit jane **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit.

Kryetar _____

Sekretar _____